

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Nashide Bajrami nga Prishtina, për kundërvajtje neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 10.08.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse ndaj Nashide Bajrami, e lindur me 11.01.1958 ne Prishtine, tani jeton ne fsh Bresalc/Gjilan, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Fiskale-Departamenti për Politika Ekonomike, e martuar, fakultetin e kryer, e gjendjes se mesme ekonomike për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare
Procedura Pezullohet konform nenit 198 par. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se ekzistojnë rrethana qe e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzime te procedurës nuk ka pasur.

Një kopje te këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit te kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit ne Prishtine, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 011605/2012 me dt. 03.04.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj te pandehurës Nashide Bajrami për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtaresve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, me te cilën kërkesë i vihet ne barre se ne Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarimin e rregullt te gjendjes se pasurisë deri me dt. 31 mars 2012.

Në bazë të kërkesë së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurën i cila deklaroi se nuk e pranon kundërvajtjen e cila i vihet mbi barre, duke dëshmuar se ushtron pozitën si Udhëheqëse Divizionit –Departamenti për Politika Ekonomike ne Ministrinë e Financave sipas Ligjit nr. 04/L-050 nuk është obligon për ta deklaruar Pasurinë.

Ne baze te dhënave nga fletëparaqitja, deklaratës se te pandehurës, deklaratës se dëshmitares Lendita Hasani, Zyrtare e Burimeve Njerëzore si dhe pika kontaktuese me mes te Ministrisë se Financave dhe Agjencinë Kundër korrupsionit, e cila deklaroi se gjate përpilimit te listave te zyrtaresve te larte cilët janë te obliguar ta deklarojnë pasurinë, se ka bërë një gabim teknik, ku gabimisht e ka dhënë edhe emrin e Nashide Bajrami.

Pas administrativit te provave u konstatua se e pandehura Nashide Bajrami e ne baze te kontratës se punës nuk është e obliguar te beje deklarimin pasurisë, andaj u konstatua se ndaj te pandehurës nuk ka prova se ka kryer kundervajten e cila i vihet mbi barre.

Gjykata e Pezulloi procedurën kundervajtese ndaj te Nashide Bajrami, konfrom nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

U VENDOS NE GJYKATEN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj 14824/12 me dt. 10.08.2012

G j y q t a r j a

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund ti parashtrroj Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

